



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.31

Prishtinë, më 27.10.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Srdjan Popović, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Sinik. .

Munguan: Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyqi
Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të MKRS –së OSBE-së, KDI- së dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të dt. 20.10.2015
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës nr.05/L-066;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 20.10.2015

Procesverbali i mbledhjes së dates 20.10.2015 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës nr.05/L-066;

Krzetari i Komisionit tha se në bazë të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional, para shqyrtimit të parë të Projektligjit në mbledhje plenare, shqyrton Projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim. Komisioni, vlerësoi se Projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim, Projektligji për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Kosovës.

Anëtarët e Komisionit njëzëri votuan për miratimin në parim të këtij Projektligji.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kinematografinë;

Komisioni, vazhdoi me shqyrtimin dhe amendamentimin nen për nen të Projektligjit, njëkohësisht duke shqyrtuar dhe analizuar vërejtjet dhe sugjerimet e propozuara me shkrim nga grupet e interesit dhe komuniteti artistik.

Anëtarët e Komisionit filluan me shqyrtimin nga neni 17 i projektligjit, me këtë rast u propozuan disa amendamente të cilat priten të rishshqyrtohen dhe riformulohen në mbledhjen e radhës.

5. Të ndryshme

Salih Morina propozoi që në mbledhjes e radhës të ftohet ministri i Arsimit, në mënyrë që të raportoi para Komisionit me zhvillimet e fundit në Universitetin Publik Hasan Prishtina.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

Përgatitur nga: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani